



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KESHILLI BASHKIAK

Nr 4301 prot

Gramsh, me 24 /01/2019

VENDIM

Nr 10 Date 23 /01/2019

PER NJE NDRYSHIM NE VKB NR.99,DATE 18.12.02017"PER NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PER VITIN 2018"

Këshilli i Bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 23 /01/2019 pasi mori në shqyrtim propozimin e bërë nga Aleanca e Grave Këshilltare në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 27/12/2018, "Per nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative" te Bashkise Gramsh, bazuar në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 24 datë 02.09.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin e përbashkët nr.655/1 datë 06.02.2007" të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore", Ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe kontrollin e teritorit", VKM nr.1064 datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave, vendimit nr 132 datë 07.03.2018 për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës, si dhe në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1, germa b, neni 20 pika 2, neni 35 pika 3 dhe neni 54 germa f:

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga pagesa e tarifave vendore familjare (tarifë pastrimi, tarifë gjelbërimi, tarifë ndricimi dhe tarifë ujra të përdorura), grupin në nevojë- gratë e veja kryefamiljare të papunësuar.

2. Verifikimi i kësaj kategorie të bëhet nga sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me zyrën e Gjendjen Civile dhe Zyrën e Punës Gramsh.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori i Tatim-Taksave pranë Bashkisë Gramsh dhe Njësitë Administrative.

Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sekretari i Keshillit
Astrit Duzha



Kryetari i Keshillit
Shkelqim Hoxha



Konceptoi A. Duzha
Pranoi
Miratoi
Konfirmoi
Dosja nr. _____
Afati _____

